

## ■ NË KONKURIM ME TETË FILMA TJERË

# "Koha e Kometës" në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Beograd

"Koha e Kometës", është përzgjedhur si "filmi më i mirë shqiptar" në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit, që u mbajt në Durrës. Ndërsa me 10 mijë shikues në Kinemanë ABC në Prishtinë, ka bërë që ky film të jetë filmi më i shikuar për vitin 2008

Filmi "Koha e kometës", i regjisorit Fatmir Koli, tani është përzgjedhur për pjesëmarrje në Festivalin ndërkombëtar të filmit - FEST në Beograd, ku do të konkurrojnë me tetë filma të tjerë në kategorinë "Europa jashtë Europës".

Në këtë kategori janë përzgjedhur tetë filmat më të suksesshëm që janë prodhuar nga shtetet që ende nuk janë pjesë e Unionit Evropian. "Koha e kometës" do të përfaqësoj Shqipërinë. Anëtarët e jurisë ndërkombëtare janë: Jeshim Ustaoglu, regjisore nga Turqia, Mihael Demopolus, ish drejtori i festi-



valit të Selanikut dhe Dubravka Lakić, kritike filmi e gazetës "Politika".

Ngjarjet e filmit zhvillohen në vitin 1914 në kohën kur fuqitë e mëdha angazhojnë një princ të huaj që të udhëheqë Shqipërinë. Këto vite të turbullta përshkruhen në librin e shkrimtarit të madh Ismail Kadare "Viti i Mbrapshtë", mbi të cilin është bazuar

edhe skenari i filmit, një bashkëpunim me kompaninë LARA Enterprises. "Koha e Kometës", është përzgjedhur si "filmi më i mirë shqiptar" në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit, që u mbajt në Durrës. Ndërsa me 10 mijë shikues në Kinemanë ABC në Prishtinë, ka bërë që ky film të jetë filmi më i shikuar për vitin 2008.

## Qahili tërhiqet nga Bordi i GAK-ut



Eshref Qahili ka thënë se dorëheqja e tij nuk lidhet me asnjë presion. Ai thotë se dëshiron të vazhdojë me punën e tij si artist, ndërsa shton se më kurrë nuk do të pranojë të jetë pjesë e ndonjë bordi.

Eshref Qahili, anëtar i Bordit të porsaformuar të Galerisë së Arteve të Kosovës, ka dhënë dorëheqje.

Dorëheqja e Qahilit vjen menjëherë pas dorëheqjes së dhënë nga kolegu i tij akademik Rexhep Ferri, i cili ka qenë po ashtu i emëruar nga ministri Beqiri, që të jetë pjesë e bordit të ri.

Qahili i ka thënë Express-it se dorëheqja e tij nuk lidhet me asnjë presion të dikujt që i është bërë atij për ta lëshuar Bordin e GAK-së, por se ai dëshiron të vazhdojë me punën e tij si artist. Ndërsa deklarohet se më kurrë nuk do të pranojë të jetë pjesë e ndonjë bordi.

"Po e kam dorëzuar dorëheqjen tek ata që më kanë caktuar. Ashtu siç

jam piktor i lirë, ashtu po dua të jem edhe tutje", tha Qahili. Qahili ka shtuar se asnjëherë nuk ka pranuar të jetë pjesë e një bordi për çështje personale, por ka qenë aty për të dhënë kontribut.

"Asnjëherë më nuk do të pranoj që të jem diku në kësi roli", tha Qahili.

Xhevdet Pantina, drejtues i Shoqatës e Artistëve Figurativë, thotë se veprimi i Qahilit do të thotë se janë kuptuar shqetësimet e kësaj shoqate rreth formimit të bordit.

Ndërsa Pantina ka thënë se askush nga kjo shoqatë nuk është pyetur rreth formimit të bordit. Pantina dëshiron të sqarohet se propozimi i Shoqatës së Artistëve Figurativë ka qenë që për bord të shoqatës të emërohen jo katër anëtarë nga kjo shoqatë, por edhe 3 anëtarë të tjerë nga shoqata tjera, një nga Ministria e Kulturës dhe një anëtar i GAK-së.

Ndërsa dorëheqja e Qahilit dhe Ferrit do të thotë se Bordi i porsaformuar i GAK ka mbetur vetëm edhe me 2 persona të tjerë, që janë të afërt me artin, e ata janë Luan Mulliqi - ish drejtor i Galerisë së Arteve të Kosovës si dhe znj. Dika, si magjistre e historisë së artit Kështu pjesa e Bordi i tanishëm ka mbetur në dorë të analistit për çështje të sigurisë Lulzim Peci, gazetares Ulpiana Lama si dhe Errolld Belegu, afarist dhe drejtuesit i Federatës së Basketbollit të Kosovës.

## Një alien në Nju Jork

Një rrëfenjë mes Tokës dhe qiellit, nën interpretimin e një komiku të pjekur dhe të matur, që na bën të qeshim dhe ta duam. Quhet Edi Mërfi. Çdo herë që del në ekran ose në skenë, qoftë me zë, apo me fytyrën e tij, spektatorët nuk mund të rrinë pa shpërthyer në të qeshura. Polic në Beverli Hills, vampir në Bruklin apo alien në Nju Jork, ylli i "zi" i Hollivudit ka lënë shenjën e ilaritetit me dinjitet në çdo rol që ka interpretuar. Nga Hollivudi, në kinema "Millenium" vjen një tjetër film që propozon një formë të pazakontë të alienëve. Behet fjalë për filmin "Meet Dave" ("Njihuni me Dejvin"). Duke nisur nga data 4 shkurt, do të nisë të shfaqet humorit amerikan, i cili ka për protagonist aktorin Edi Mërfi. Në filmin e drejtuar nga Brajan Robins, alienët nuk janë gjë tjetër veçse disa qenie të vogla të ngjashme me liliptutët tek "Udhëtimet e Gulliverit", shumë të ngjashëm me njerëzit, por edhe më të zhvilluar se ne. Ata mbërrijnë në Tokë, pasi kanë ndërtuar një anije në formën e Edi Mërfit. Nëpërmjet kësaj anijeje me emrin "Dave Ming Chang", kapiteni i saj, i interpretuar sërish nga Edi Mërfi, do të arrijë në Tokë, për të eksploruar një botë të re, të mbushur me ndjenja të panjohura nga raca e tij, e njëra prej tyre është dashuria. Te "Meet Dave", alientë vijjnë në paqe, duke i dhënë jetë një filmi që është njëkohësisht aventurë klasike, komedi sentimentale, rrëfim personal dhe kolektiv. Sjellja paqësore e alienëve të udhëhequr nga kapiteni filantrop Edi Mërfi, frymëzon një botë fantastike, optimiste dhe diellore.

## ■ ARTE PAMORE

# ANRI SALA NË NJË BO

Shtëpia Botuese e Londrës, "Phaidon", prijëse në botë për artet pamore, ka botuar albumin "Anri Sala", ku janë përfshirë pjesa më e madhe e krijimtarisë së artistit nga Tirana, në lloje të ndryshme të arteve pamore. Botimi është i pari i këtij lloji që i kushtohet një artisti shqiptar

Në vitin 2006, Shtëpia Botuese e Londrës, "Phaidon", prijëse në botë për artet pamore, vuri në qarkullim albumin "Anri Sala". Në të përfshihet pjesa më e madhe e krijimtarisë së Anri Salës, artistit nga Tirana, në lloje të ndryshme të arteve pamore. Botimi është i pari i këtij lloji që i kushtohet një artisti shqiptar, çka përbën një sukses, por edhe nder jo vetëm për autorin, por për të gjithë shqiptarët, sidomos ata që lëvrojnë këto arte. Njëkohësisht, ky album i shtëpisë botuese më të njohur në botë për artet pamore, në të njëjtën kohë shumë e rreptë për cilësinë e lëndës, e nxiti edhe më tepër njohjen e emrit të tij në qarqet artistike botërore. Sigurisht botimi e ka nxitur edhe vet artistin për të punuar ende më shumë për më tepër krijime të reja cilësore.

Vlen të përmendim se Anri Sala është lindur në Tiranë më 1974, gjatë 1992-1996 ka kryer Akademinë e Arteve për arte figurative. Pak më

vonë largohet jashtë vendit, në Francë, ku studion video në "Ecole Nationale des Arts Decoratifs" dhe regjizurë filmi në "Le Fresnoy-Studio National des Arts Contemporains, Tourcoing". Videoja e tij e vitit 2003, "Dammi i color" ("Më jep ngjyrat"), është e ekspozuar në "Tate Modern" (Muzeu i Artit Modern Ndërkombëtar) të Londrës dhe pasqyrojnë ndryshimet koloristike të fasadave të Tiranës.

Duke punuar në disa drejtime në artet pamore, pikturë, grafikë, video, instalacione, fotografi, filma etj., Anri Sala u bë pjesëmarrës në mjaft ekspozita me emër në qytete të ndryshme të Europës, ku tërhoqi edhe vëmendjen e specialistëve për nivelin e punimeve të tij.

Po në vitin 2006, "Phaidon" nxori në qarkullim botimin me titull "Vitamin Ph-Neë Perspectives in Photography" ("Vitamin F-Perspektiva të reja në Fotografi"), mbi 350 faqe. Në

## ■ VILSON KILICA

# DITËT E LIRISË SË N

Kavaleta nuk qëndron asnjëherë bosh. As ngjyrat nuk mungojnë. Dhoma e mbushur me piktura të ekspozuara apo të sistemuara në hapësirën e saj, është vend-arratisja e piktorit. Ditët e një artisti në pension pëlqen t'i harxhojë më së shumti në këtë kthinë të frymëzimeve artistike. Ngjyrat që Vilson Kilica hedh këto ditë mbi telajo, përvijojnë një peizazh të periferisë së Tiranës. Një copëz rrugë e asfaltuar, një terren disi kodrinor që i gëzohet gjelbërimit, një qiell pa diell...dhe fabula vazhdon. Ky peizazh nuk është i vetmi në llojin e tij. Pas '90-ës, peizazhi e intrigon më së shumti se çdo gjini tjetër piktorin. Arsyet? Mund të rendisësh disa. Për t'u shprehur, për të mbushur ditët, por mbi të gjitha, ashtu siç ai thekson, për t'u çliruar. Ndërsa gjithnjë e më shumë, politikisht apo në një kuadër më të gjerë social, në ditët e sotme diskutohet për të shkuarën shqiptare të 50 viteve, Kilica ka zgjedhur "arratisjen" përmes peizazhit nga tematikat e imponuara për vite me radhë. "Ne krijuam në një klimë, ku në mos i detyruar, duhet t'i përshatashë kërkesës për vepra tematike të rëndësishme. Kështu që punët e mia, por edhe të piktorëve të tjerë, kryesisht pasqyrojnë atë realitet, qoftë të saj kohe apo të së shkuarës historike. Për këtë arsye, pas viteve '90 më lindi një dëshirë për t'u marrë me peizazhin. Ndjeva nevojën të çlirohesh nga një tematikë pak a shumë e imponuar dhe të merresha

me ndonjë temë të lirë si peizazhi, e ndonjëherë edhe portreti", shprehet Kilica. Çdo tri-katër ditë nis nga një punë të re. Nëse e shkëput penelin, e ka të vështirë të hyjë sërish në frymëzimin e pikturës. Shëtit kryesisht në rrethinat e Tiranës. Iba, Peza, zona kodrinore që e ngacmojnë me arkitekturën piktoreske. "Jam i lirë për ta interpretuar natyrën siç e mendoj. Në ndryshim nga piktura e disa viteve më parë, jam çliruar nga disa stresa ideologjike që duhet t'i respektoje", tregon Kilica teksa nga pikturat e sistemuara kërkon një portret të hershëm të gruas së tij, një nga ato piktura që mund të bëheshin vetëm brenda mureve të studios. E ulur në një karrige, ende në moshë të re, e shoqja ka pozuar për të. Përzierë me kujtimet e asaj kohe, me një nënqeshje në buzë, piktori shprehet se këtë portret e ka realizuar nën ndikimin e piktorit të njohur italo-francez, Modeliani. Me veprat e tyre ishte njohur në kohën e studimeve në Leningrad (Shën Petërburgu i sotëm). Atje mësoi mjeshhtërinë artistike të pikturës realiste. Ndërsa kati i tretë i muzeut me kryevepra botërore, të artistëve italianë, anglezë e francezë ishte një nga vendet që adhuronte ta vizitonte shpesh. "I shihja me dashuri të madhe veprat e piktorëve të impresionizmit francez. Aty mësoje edhe një teknikë të re, këndvështrimin e interpretimit të natyrës. Më vonë më tërhiqte edhe krijimtaria e Pikasos, shtrirja dhe planet e gjera të pik